

**MBI**  
**AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**KOMUNËN DAJT**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Komunën Dajt, njësi administrative e Bashkisë Tiranë**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, për periudhën e veprimtarisë 1.01.2013 deri më datë 01.03.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 65, datë 30.05.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 182/6, datë 30.05.2015, i ka rekomanduar z.Kujtim Qefalia, Kryetar i komunës Dajt, , zbatimin e masave të mëposhtme:

**A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga 11 masa organizative të rekomanduara me efekt financiar në vlerën 5,927,200 lekë, janë arkëtuar 3,240,000 lekë dhe mbeten për tu arkëtuar 2,687,200 lekë, detyrime të cilat nuk janë arkëtuar, pasi janë në proces gjyqësor. Lidhur sa më sipër rezulton se janë zbatuar plotësisht 6 masa, ndërsa 4 masa janë zbatuar pjesërisht dhe një masë nuk është zbatuar. Për 8 masa për shpërblim dëmi në vlerën 7,976,184 lekë, është arkëtuar vlera 2,148,395 lekë dhe mbetet për tu arkëtuar shuma 5,827,789 lekë, detyrime të cilat janë në proces gjyqësor.

**1.1.Rekomandim:** Komuna Dajt, të marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna më parë nga KLSH, duke zbatuar të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e shumës 2,687,200.

**Deri më datë 31.12.2015**

**2..Gjetje nga auditimi:** Në këtë Institucion kontabiliteti është organizuar mbi bazën e planit kontabël, me ditarë analitikë, ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël të organeve të pushtetit lokal, institucioneve shtetërore qendrore e lokale, si dhe të njësisve që varen prej tyre”, i ndryshuar. Gjithsesi nga auditimi i kryer, rezultoi se për vitet 2013 dhe 2014,2015 nga Komuna Dajt nuk është kryer inventarizimi i aktiveve afatgjata, pra asetet e Komunës.

**2.1 Rekomandim:** Komuna Dajt të marrë masa për inventarizimin e aktiveve afatgjata, asetëve të Komunës në përputhje me kërkesat ligjore.

**Në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit “*Blerje Materiale inerte*” rezultoi se me datë 29.8.2014 janë bërë dalje 600 m<sup>3</sup> pa i patur gjendje në magazinë, gjithashtu në të gjitha rastet e furnizimit të sasive të ndryshme të inerteve është bërë hyrje në magazinë e pashoqëruar me dokumente justifikuese si fletë analizë për cilësinë, markën e inerteve dhe përmbajtjen e argjilit, sipas specifikimeve teknike të kërkuara, veprime këto që bien në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik.

**3.1 Rekomandim:** Autoriteti kontraktor të marrë masa që Komisioni i Marrjes në dorëzim të zbatojë Udhëzimin Nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, në lidhje me aktivet e furnizuara në magazinën e institucionit të shoqëruara me dokumentacionin përkatës.

**Në vijimësi**

**4. Gjetje nga auditimi:** Në përcaktimet dhe miratimet e kriterëve të veçanta të kualifikimit, ka shkelje e mangësi, pasi kriteret e përdorura për identifikimin e ofertës me çmimin më të ulët nuk i plotësojnë kushtet e nenit 46 dhe 55, pika 1, e LPP-së, pasi nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, nuk janë të përcaktuara qartë në njoftimin e kontratës apo në dokumentet e tenderëve, duke favorizuar operator ekonomik të caktuar.

**4.1 Rekomandim:** Autoriteti kontraktor, Njësia e Prokurimit të marrë masa për përcaktimin e kriterëve të kualifikimit sipas kërkesave ligjore, duke patur parasysh që të jenë objektive dhe të argumentuara teknikish dhe sipas nevojës për konkurim.

**Në vijimësi**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga përpunimi i të dhënave, rezulton se nga Komuna Dajt, planifikimi i taksave për ndërtesën dhe tokën bujqësore, nuk bëhej sipas mundësive reale që ka kjo komunë, pasi taksa e ndërtesës për abonentët familjarë nuk aplikohet sipas sipërfaqeve

që ato zotërojnë realisht (nuk ka dokumentacion të saktë (genplane) dhe regjistra të cilat të pasqyrojnë sipërfaqet e objekteve).

Gjithashtu për fshatin Qesarakë, fshat ku është dhe pjesa më e madhe e ndërtimeve të reja (apartamente), nuk ka asnjë informacion se sa është numri i familjeve duhet të paguajnë, vlera e detyrimit të paguar dhe sa janë paguar, pagesë e cila bëhej në zyrën e pagesave të ujit. Nuk është mbajtur asnjë akt-rakordim mbi numrin e familjeve që kanë paguar dhe atyre që nuk kanë paguar dhe detyrimi aplikohet si mesatare, duke përlogaritur një sipërfaqe prej 100 m<sup>2</sup>, dhe jo sipas sipërfaqes që ato zotërojnë realisht, veprime në kundërshtim me nenin 22, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Taksat Vendore”, i ndryshuar.

Për taksën e tokës bujqësore, konstatohet se sipërfaqja e tokës së ndarë është **prej 1725.3 ha**, kurse nga zyra e taksave vendore, është planifikuar një sipërfaqe **prej 1251 ha**, pra me një diferencë prej 474 ha. Këta tregues, bëjnë që planifikimi i kësaj takse të mos jetë sipas sipërfaqes së tokës së ndarë, me një diferencë prej 480 ha për një vlerë të patakshuar në **shumën 1,129,800 lekë**, e ardhur e munguar në buxhetin e komunës .

**5.1 Rekomandimi:** Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masa për:

a. Planifikimin real të taksave e tarifave vendore (taksë ndërtese dhe tokës bujqësore), bazuar në të dhënat që disponon komuna dhe realizimeve të mëparshme, duke i programuar ato në mënyrë analitike, që niveli i planifikimit të tyre të vijë në rritje nga njëra periudhë në tjetrën.

**Në vijimësi**

b. Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për evidentimin e familjarëve të cilat nuk disponojnë tokë bujqësore dhe të patakshuar për periudhën objekt auditimi, si dhe të përlogariten dhe arkëtohen detyrimet e pa taksuara në shumën 1,129,800 lekë, e ardhur e munguar në buxhetin e komunës.

**Deri më datë 31.12.2015**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga personat përgjegjës të Zyrës së Taksave e Tarifave Vendore (ZTTV) ka munguar ndjekja dhe kontrolli i veprimtarisë së agjenteve tatimor, për rrjedhojë ndjekja e vjeljes së “Taksa mbi kalimin e drejtës pronësisë për pasurinë e paluajtshme, nga agjenti tatimor ZVRPP Tiranë” dhe taksën e Regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit, ka qenë jashtë kontrolli .

**6.1 Rekomandim.** Nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masa organizative dhe ligjore për një ndjekje dhe arkëtim të taksave që arkëtohen nga njësitë e tjera publike (*D.P.SH.T.Rr Tiranë, ZVRPP Tiranë*) etj, duke kërkuar e bërë rakordime periodike dhe ushtrimin e të drejtës ligjore për të ndikuar mbi agjentët tatimor, të cilët duhet të sjellin ndryshime në rritje për treguesit e planifikimit, realizimit në fakt të ardhurave.

**Në vijimësi**

**7. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e debitorëve më 31.12.2014 paraqitet në **shumën 3,842,670 lekë**, nga e cila; juridik për 19 subjekte me vlerë 3,283,750 lekë (pasqyra aneks 3 dhe 4) dhe fizik për 16 subjekte me vlerë 558,920 lekë (pasqyra aneks 4).

**7.1 Rekomandim:** Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa për evidentimin, saktësimin e subjekteve debitorë në fund të periudhave ushtrimore 2013 dhe 2014 dhe përcjellja e tyre në Zyrën e Financës, me qëllim pasqyrimin në pasqyrat financiare të Komunës Dajt dhe ndjekjen e tyre në vazhdimësi.

**Në vijimësi**

**7.2 Rekomandim:** Zyra e Taksave Vendore, të marrë masa, të kontabilizoj dhe të kërkoj në rrugë administrative e ligjore arkëtimin e detyrimit të papaguar brenda afateve ligjore, për 35 subjekte me vlerë prej 3,842,670 lekë.

**Deri më datë 31.12.2015**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga ZTT Vendore Komuna Dajt, nuk janë aplikuar sanksione për mos likuidim në afat të detyrimeve (sipas periudhave), për vlerën 965,480 lekë, nga e cila; fizik në shumën 139,730 lekë dhe juridik në shumën 825,750 lekë .

**8.1 Rekomandim:** Zyra e Taksave Vendore, të marrë masa, të kontabilizoj dhe të kërkoj në rrugë administrative e ligjore arkëtimin e gjobës për detyrimin e papaguar në afate ligjore për vlerën prej 965,480 lekë.

**Deri më datë 31.12.2015**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit të dosjeve për dhënien e lejeve të zhvillimit dhe ndërtimit në dosjet me nr. 31; nr. 32 dhe nr. 34 rezultoi se kishte të meta dhe mangësi si mungesa e hartave treguese, plan vendosja bashkangjitur, distanca e lejes së zhvillimit, licenca e subjektit ndërtues e pa noterizuar, inventari i marrjes në dorëzim,

nuk është i rregullt, pra pa marrës dorëzim dhe dorëzues, por me shënime dore, veprim në mospërputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” .

**9.1 Rekomandim:** Komuna Dajt të plotësojë mangësitë në dosjet për dhënien e lejeve të ndërtimit.

**Deri më datë 31.12.2015**

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kryer rezultoi se prej IMKT janë nxjerrë **34 vendime administrative me gjobë**, sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore për periudhën shtator-dhjetor 2013 janë marrë 5 vendime, 27 vendime për vitin 2014 dhe 2 për periudhën janar –shkurt 2015..Nga dokumentacioni i paraqitur nga administrata e Komunës Dajt rezultoi se 14 persona fizik dhe 17 subjekte, janë debitorë kundrejt Komunës Dajt në vlerën **6,580,000 lekë**. Lidhur me sa më sipër Komuna Dajt ka bërë depozitimet përkatëse pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, depozitime të cilat janë kryer gjatë periudhës së Auditimit (24.02.2015-15.04.2015) fakt i cili bie në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ”Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, me ndryshime, ekzekutimi i vendimeve për gjobat duhej të kërkohej në rrugë gjyqësore.

**10.1 Rekomandim:** IMKT të marrë masa në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, për të evidentuar e kontrolluar në mënyrë të vazhdueshme ndërtimet pa leje, duke aplikuar gjoba dhe masa pas vijuese ndëshkimore ndaj subjekteve ndërtuese të kundërligjshëm, në zbatim të nenit 5, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “ Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar .

**Në vijimësi**

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga përpunimi i listave të paraqitura mbi subjektet me derdhje të viteve 2013 dhe 2014, rezulton se disa subjekte megjithëse kanë qenë aktiv gjatë vitit 2013, si dhe nuk kanë kërkuar mbyllje aktiviteti, nuk është bërë i mundur aplikimi i detyrimeve për taksat/tarifat të vitit 2014, konkretisht kjo për **27 subjekte me vlerë 600,930 lekë**, e cila konsiderohet si mungesë të ardhurash në buxhetin e Komunës.

**1.1 Rekomandimi:** Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, të saktësojë, kontabilizojë dhe arkëtoj detyrimin e **27 subjekteve** të biznesit të vogël, për **vlerën 600,930 lekë** (për periudhën 2013 - 2014), mbi bazën e njoftim vlerësimit të nxjerrë .

**Deri më datë 31.12.2015**

**2. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit “*Blerje Materiale inerte*” rezultoi se ka diferenca ndërmjet sasisë sipas preventivave hartuar në fillim të punimeve nga ing. A.B dhe situacioneve hartuar në përfundim të tyre, po nga i njëjti person. Nga krahasimi shumëve në total të preventivave (hartuar mbas datës 1.9.2014 kur mallrat sipas kontratës janë lëvruar) krahasuar me situacionet rezulton se nga firma “S.....” janë tërhequr më shumë stabilizant 2007.5-1848=159.5 m<sup>3</sup> në vlerën **95,700 lekë** (pa TVSH), shumë e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e komunës Dajt.

**2.1 Rekomandim:** Autoriteti kontraktor të marrë masa për arkëtim dhe kontabilizimin e shumës **95,700 lekë** (pa TVSH) që është përfituar tepër nga firma fituese “S.... ”.

**Deri më datë 31.12.2015**

**3. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit “*Blerje karburanti Gazoil dhe benzinë*” rezultoi se llogaritja e çmimit të karburantit është bërë në kundërshtim me Dokumentet standarde të tenderit, për pasojë subjekti “E.... ” ka përfituar padrejtësisht shumën **244,302 lekë** në total, e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e Komunës Dajt.

**3.1 Rekomandim:** Autoriteti kontraktor të marrë masa për arkëtim dhe kontabilizimin e shumës **244,302 lekë** (pa TVSH) që është përfituar tepër nga firma fituese “E.....”

**Deri më datë 31.12.2015**

## **B/1.MASA PËR MOS PËRDORIMIN ME EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE(3E).**

**1. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e procedurave të prokurimit në tenderat e zhvilluar, u konstatuan se në prokurimin e kryer me vlerë kontrate **31,503,779 lekë** (pa tvsh), ka mos përmbushje të rregullave të caktuara në procedurat e prokurimit, mos përdorim me efektivitet, efencë dhe ekonomikitet të fondeve publike të vëna në dispozicion, si dhe

përdorimin me diferencë negative në fondet buxhetore në vlerën totale **3,841,436 lekë**. Mbas shqyrtimit të këtyre sqarimeve mangësitë e konstatuara, duhet të konsideroheshin devijime të vogla sepse ato nuk preknin dhe nuk ndikonin në ekzekutimin e kontratës. Nisur edhe nga ofertat më të leverdishme në tender këta operatore duhet të kualifikoheshin dhe më pas të shpallej fitues operatori ekonomik që kishte paraqitur ofertën më të leverdishme në këtë procedurë, që në rastin konkret është operatori ekonomik “Gj... n”. Vlerë kjo që përcaktohet në objektin; *“Ndërtim i rrugës lidhëse Tiranë -Dajt në vlerën 27,325,410 lekë, veprime këto në kundërshtim me nenin 1, 2 dhe 24, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe kreu V, pika 1/a dhe pika 4/h, të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar.*

**Rekomandimi:** Komuna Dajt të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë, duke nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë, për mos përdorimin me efektivitet, economicitet dhe efikasitet të fondeve publike, për procedurën e prokurimeve me efekte negative në përdorimin e fondeve publike në vlerën **31,503,779 lekë** (pa tvsh), duke vënë theksin në rritjen e vlerës së shtuar nga përdorimi i fondeve publike në shërbim të komunitetit.

**Brenda muajit Korrik 2015**

### **C. MASA DISIPLINORE**

**C.I.** Mbështetur në nenin 58, germa a, b, c, ç, *“Llojet e masave disiplinore”*, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 *“Për nëpunësin civil”*, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”*, si dhe nenit 8, të kontratave individuale të punës, në nenin 44, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, *“Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”*, I kemi kërkuar Kryetarit të Komunës Dajt , vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga **“Vërejtje”** deri në **“Largim nga puna”** dhe për ata me kontratë, nga masa **“Vërejtje”** deri në **“Ndërprerje të marrëdhënieve të punës”**, për këta punonjës:

1. z. A.R me detyrë K/inspektor i IMKT të Komunës Dajt

2. z. F.Sh dhe 3. znj. L.S me detyrë inspektore e IMKT

4. znj. A.Pi me detyrë juriste Komunës

Për mos nisjen e procedurave ligjore në kohë, për ekzekutimin e 31 gjobave , veprim i cili i ka shkaktuar buxhetit të Komunës Dajt të ardhura të munguara në vlerën 6,580,000 lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”*, me ndryshime, ekzekutimi i vendimeve për gjobat duhej të kërkohej në rrugë gjyqësore, bazuar në nenin 16, me ndryshime, ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 *“Për urbanistikën”* i ndryshuar, ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 *“Për kundërvajtjet administrative”* përkatësisht nenet, 9, 22 dhe 30, VKM nr. 862, datë 5.12.2007 *“Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati ndërtimor e urbanistik kombëtar e ai vendor”* (Ndryshuar me vendim të KM nr .625, datë 28.7.2010).

5. z. F.S me detyrë përgjegjës i zyrës së taksave

6. znj. H.A ,7. z. P.C ,8. z. Z.K,9. znj. S.R dhe 10. z. H.Sh me detyrë inspektorë të zyrës së taksave;

Për vjeljen e detyrimeve tatimore të paraqitura nga ana e ZTT Vendore Komuna Dajt, nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008 *“Për Procedurat Tatimore”*, me ndryshime, si;

- Nuk u janë dërguar Bankave të nivelit të dytë për subjektet debitorë, në zbatim të nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008;

- Nuk është kërkuar, që ndaj subjekteve debitorë, vendosja e barrës siguruese në Drejtorinë Rajonale të Transportit për mjetet, apo ZVRPP Tiranë, bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008;

- Nuk janë zbatuar procedurave të parashikuara në Kreu XI-*Mbledhja me forcë e detyrimeve të papaguara*, i ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008 *“Për Procedurat Tatimore”* me ndryshime, pasi nuk është proceduar në mbylljen e subjekteve debitor të cilët nuk kanë likuiduar detyrimet për taksat e tarifatat vendore;

-Nuk është bashkëpunuar me DRT Tiranë/DRT e Tatimpaguesve të Mëdhenj për arkëtimin e detyrimeve debitorë të subjekteve të Biznesit të Madh.

- Nuk janë aplikuar sanksione për mos likuidim në afat të detyrimeve (sipas periudhave), për vlerën 965,480 lekë, nga e cila; fizik në shumën 139,730 lekë dhe juridik në shumën 825,750 lekë (pasqyra aneks nr. 3 dhe 4),

Për mos planifikimin e saktë të taksës bujqësore pasi referuar të dhënave të zyrës së kadastrës sipërfaqja e tokës së ndarë rezultoi 1725.3 ha ndërsa nga zyra e taksave planifikimi është bërë për sipërfaqen 1251 ha duke sjell mungesë në shumën 2,270,000 lekë.

*11. Z. Sh.S, 12. Z. V.K,13. Znj. A.P në cilësinë e antëtarit të Njësisë së prokurimit, për më poshtë:*

Për shkelje në proceduar e prokurimit në 2 tendera.

**I. Në tenderin blerje materiale hidraulike për nevojat e Komunës Dajt**

Tek kriteret e veçanta të kualifikimit **Pika 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar 2.2.1:** është kërkuar nga operatorët ekonomik një kopje deklarimit të xhiros vjetore për tre vitet e fundit 2011, 2012, 2013, lëshuar nga dega e Tatim Taksave ku xhiroja mesatare vjetore gjatë tre viteve të fundit duhet të ketë një vlerë jo më të ulët se fondi limit.

Njësia e Prokurimit ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Kreu III pika 3 germa “b” ,

- Në përcaktimin e kriterëve teknike dhe konkretisht “Kapaciteti teknik”, **pika 2.3.1,** Njësia e Prokurimit ka vepruar në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Kreu III, pika 3 germa “b”, ndërkohë sipas llogaritjeve 40% e vlerës së kontratës 4,507,0333 lekë pa TVSh ( $40\% * 4,507,0333 \text{ lekë} =$ ) është **1,802,813 lekë pa TVSh.**

-Nga verifikimi në rrugë elektronike rezultoi se nuk janë respektuar afatet e dorëzimit të dokumenteve për konkurrim. Urdhri i prokurimit ka dalë me datë 05.05.2014, njoftimi i kontratës është bërë publike në faqen e APP-së në datë 20.05.2014, ndërsa në datë 02.06.2014 është caktuar dita e tenderit (data e fundit për dorëzimin e dokumenteve).

**II. Për tenderin blerje materiale inerte**

Në procesverbalin e Njësisë së Prokurimit për hartimin e DST rezulton se nuk ka të argumentuara plotësisht Specifikimet teknik (Sasinë).

Kufiri Monetar nuk është i argumentuar me projektet sipas emërtimeve të rrugëve sipas fshatrave, gjatësisë e përmasave të tyre, shkallës dhe nevojave analitike për çdo rrugë.

*14. Z. B.B në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave*

*15. Z. Njazi Deliu dhe 16. Z. Shefqet Kamberi, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave,*

*17. z. Adhurim Beqaj, në cilësinë e hartuesit të preventivit, për sa më poshtë vijon:*

*Për tenderin blerje materiale hidraulike*

**1-** Tek DST Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar, Pika 2.2.4 është kërkuar që operatori ekonomik të ketë kopje të bilancit të vitit 2013 të konfirmuar nga administrata tatimore në çdo fletë.

Në dokumentat e dorëzuar nga firma fituese “S.....” mungon kopja e bilancit të vitit 2013 çka bie në kundërshtim me VKM nr.1 datë, 10.01.2007 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Kreun III pika 3 germa “b” dhe “i” .

**2-**Listë pagesat për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën Janar-Dhjetor 2013 dhe Janar-Mars 2014 nuk janë të konfirmuara dhe të vulosura në çdo fletë nga dega e sigurimeve shoqërore, në kundërshtim me pikën 2.3.1 të DST-ve,

*Për tenderin blerje materiale inerte*

Rezultoi se me datë 29.8.2014 janë bërë dalje 600 m3 pa i patur gjendje në magazinë, veprim që është në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, nuk është vepruar në zbatim të plotë me Udhëzimin Nr. 30, datë 27.12.2011 ”Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik pikat 34, 35 germa “a” dhe “b”, 37 dhe 39.

Nga krahasimi shumave në total të preventivave (hartuar mbas datës 1.9.2014 kur mallrat sipas kontratës janë lëvruar) krahasuar me situacionet rezulton se janë tërhequr më shumë stabilizant 2007.5-1848=159.5 m3 në vlerën 95,700 lekë (pa TVSH).

*Për tenderin “Ndërtimi i rrugës lidhëse Tiranë-Dajt*

KVO në zbatim të pikës 1 dhe 4 të nenit neni 53 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” duhej ti kërkonte sqarime operatoreve ekonomik të skualifikuar, “Gj.....” dhe “BE-IS”, për mangësitë e konstatuara në dokumentacionin teknik, për ti shqyrtuar dhe krahasuar ofertat e tyre sa më drejtë në raport me ofertën e kualifikuar dhe të shpallur fituese. Mbas shqyrtimit të këtyre sqarimeve mangësitë e konstatuara, duhet të konsideroheshin devijime të vogla sepse ato nuk preknin dhe nuk ndikonin në ekzekutimin e kontratës. Nisur edhe nga ofertat më të leverdishme në tender këta operatore duhet të kualifikoheshin dhe më pas të shpallej fitues operatori ekonomik që kishte paraqitur ofertën më të leverdishme në këtë procedurë, që në rastin konkret është operatori ekonomik “Gj.....” në vlerën 27,325,410 lekë, pa TVSH ose me ofertën më të vogël se fituesi me një diference prej 3,841,436 leke pa TVSH.

Pra, si pasoje e këtyre shkeljeve AK nuk ka përmbushur qëllimin kryesor i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i sanksionuar në nenin 1 që ka të bëjë, me mirëpërdorimi i fondeve publike, me kursimin e tyre dhe, me sigurimin e trajtimit të barabartë dhe jo diskriminues të operatoreve ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, duke bërë që 4,609,723 lekë me TVSH, fonde buxhetore të mos i kursehen buxhetit të Komunës.

Nga Komuna Dajt, është kthyer përgjigje sëbashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar plotësisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

*Shënim:* Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Abdulla Duka, Rezart Golemaj, Rajmond Koçi, Selman Hysa dhe Luan Kuka, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT